

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

5.02.2025

Ora 12:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj.M. Çelmeta, znj.P. Doçaj, znj.A. Agolli**
- **Parti Politike: PD (z. F. Nuri), PS (znj. E. Xhina)**
- **OJQ: KRIIK**

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 12.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme, kemi për shqyrtim një projektvendim. Projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit do të pyesja së pari kolegët dhe pastaj përfaqësuesit e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

partive politike nëse ka çështje jashtë rendit të ditës, në mënyrë që të mbajmë radhën e folësve. Kolegë? Nuk ka. Nga ju, përfaqësuesit e partive? Ka z. Nuri, dakord. Pasi të mbarojmë çështjen që kemi në shqyrtim në rendin e ditës, do t'ia japim fjalën z. Nuri, jashtë rendit të ditës. Atëherë projektvendimi është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kështu që para se të fillojmë me shqyrtimin e tij do të doja një relativitet të shkurtër nga ana e administratës, zonja Doçaj.

Znj. P. Doçaj:Faleminderit! Do të bëj një përmbledhje të shkurtër edhe për ekonomi të kësaj seance. Relacioni është i ndarë në tre kapituj, fillimisht kemi vlerësimin e ligjshmërisë dhe harmonizimin e legjislacionit, në mbështetje të nenit 20, ku parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, jemi mbështetur në nenin 91 të Kodit Zgjedhor ku parashikohen ndalime të burimeve publike dhe duke vlerësuar ligjshmërinë mendojmë që ky akt është në kompetencën e Komisionit Rregullator për t'u shqyrtuar. Një përmbledhje të shkurtër në lidhje me përmbajtjen e projektvendimit. Në zbatim të dispozitave të sipër cituara është hartuar projektvendimi "Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike", i cili ka për qëllim marrjen e masave, monitorimin dhe parandalimin e veprimtarisë së sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare, logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe të administratës shtetërore katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, si dhe gjatë fushatës zgjedhore, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, për krijimin e kushteve dhe të drejtave të barabarta për të gjithë kandidatët, për partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake. Hartimi i këtij akti vjen si nevojë për reflektimin e disa ndryshimeve që janë


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

vëzhguar përgjatë zgjedhjeve të kryera në vend, të shkuara. Ky akt synon përmirësimin dhe adresimin e të gjitha shqetësimeve apo problematikave të hasura deri në ditën e sotme nga aplikimi i vendimit nr. 9, gjithashtu dhe nga shqyrtimi i kërkesave të Komisionerit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, ku janë evidentuar disa nevoja urgjente për rishikimin e këtij vendimi. Akti është i hartuar në tre krerë, ku në kreun e parë përcaktohet qëllimi, përkufizimi dhe rregulla të përgjithshme, në kreun e dytë parashikohen kategoritë e ndalimeve dhe në kreun e tretë përcaktohen dispozitat e fundit. Subjektet e këtij vendimi janë institucionet publike dhe administrata shtetërore, veprimtaritë publike, janë të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose që pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe informimit publik, si të tilla por pa u kufizuar në media online, rrjete sociale, faqe interneti etj. “Veprimtari të ndaluara” do të konsiderohet çdo veprimtari apo akt i institucionit publik dhe/ose i administratës shtetërore, e cila keqpërdor asetet publike dhe ndalohet për t’u kryer. Asete publike përfshijnë burimet njerëzore, financiare, materiale dhe logjistike si dhe çdo aset tjetër i luajtshëm apo i paluajtshëm, sipas përcaktimeve të nenit 142 të Kodit Civil. Ky projektvendim i është njoftuar partive politike për njohje, organizatave, medias e të tjerë, nuk kemi pasur ndonjë feedback nga partitë politike, i vetmi rekomandim është ai i KRIIK-ut, ku në rekomandimet që shqyrtojmë ka të bëjë me unifikim të disa terminologjisë që për ne kanë kuptim dhe që duhet të reflektohen apo të akomodohen në këtë akt. Nisur nga sa më sipër dhe brenda kompetencave tuaja sjellim për shqyrtim projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Doçaj! Fillojmë me diskutimin në parim, kush e do fjalën? Z. Çakaj.

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare! Unë kisha dy pyetje për administratën. Atëherë gjatë leximit të relacionit për projektvendimin e paraqitur ju evidentuat se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar problematika në lidhje zbatimin e vendimit nr. 9, gjatë zgjedhjeve të ndryshme. Mund të kemi ndonjë detaj, kryesisht cilat problematika thelbësore janë evidentuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ose administrata?

Znj. P. Doçaj: Po, duke qenë se i gjithë projektvendimi në lidhje me rregullat e sjelljes së institucioneve publike dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike, në tërësi të tij ka të sqaruara dhe të detajuara problematikat e hasura që në keqinterpretim të terminologjisë apo keqinterpretim të veprimtarive të ndaluara. Nga ana e administratës është konstatuar, jo vetëm në zgjedhjet e shkuara, por dhe në këto zgjedhje që kanë paqartësi nga institucionet që deklarojnë veprimtaritë apo ato që na kërkojnë interpretim të vazhdueshëm, në lidhje me terminologjinë e veprimeve të ndaluara, nëse janë të tilla apo jo. Ne mendojmë që në këtë akt ezaurojmë tërësisht apo shterojmë tërësisht këtë lloj problematike në interpretimin e veprimtarive të ndaluara. Mendojmë që është shterues dhe i jep zgjidhje interpretimit të veprimtarive të ndaluara apo përdorimit të aseteve publike.

Z. M. Çakaj: Qartë, po me një problematikë konkrete, pra paqartësia e institucioneve, të cilët kanë nevojë ose të raportojnë ose mos ta kryejnë një veprimtari, kur konsiderohet veprimtaria e ndaluar? Kemi ndonjë fakt konkret? Ndonjë paqartësi konkrete? Pra, një casus, një çështje konkrete, në të cilën është

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

hasur vështirësi qoftë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në hetimin e çështjes dhe janë evidentuar paqartësi, qoftë edhe nga vendimmarrja e Komisionerit apo e KAS-it. Konkretisht kemi ndonjë çështje konkrete, ndonjë përkufizim konkret, ndonjë nocion konkret, i cili është i paqartë?

Znj. P. Doçaj: Të gjitha, ashtu siç edhe e thashë, ka lindur nevoja për këtë projektvendim pikërisht për të kategorizuar në mënyrë më të detajuar se cilat janë kategoritë e ndalimeve dhe ne prandaj e kemi sjellë në këtë akt, në këtë formë. Pra ndalimin e miratimit të akteve juridike për shembull, ka institucione që pyesin në vazhdimësi, ky akt juridik mund të miratohet apo jo? Miratohet katër muaj përpara apo jo? Janë nga ato akte të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit të shkuar apo jo? Pra, janë raste konkrete, çdo institucion ka nga një rast konkret. Kemi pasur raste kur na janë drejtuar për inagurimin e një spitali apo për zhvillim e një koncesioni apo, pra në çdo institucion ka dinamikën e vet. Ne nuk mund t'i...

Z. M. Çakaj: Qartë. Nuk po them që t'i citoni të gjitha po disa konkrete, të cilat kanë lindur nevojën për ndryshimi. Pra, ju thoni miratimi i akteve juridike është i paqartë se çfarë konsiderohet e ndaluar ose periudha se kur lejohet, qartë. Apo proceset të ndryshme promovuese, siç mund të jetë një godinë apo spitali.

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me promovimin e veprimtarive publike janë të paqartë nëse një veprimtari është publike dhe promovohet dhe ku promovohet? Në rrjete sociale, jo? Na kontaktojnë vazhdimisht për të thënë a ka karakter politik apo karakter institucional? Pra ka paqartësi ndoshta dhe në kuptimin se çfarë konsiston promovim i një veprimtarie publike.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*


Z. M. Çakaj: Po, qartë. Kam dhe një pyetje tjetër...

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me përdorimin e asetëve publike, pra nëse përdoren shkollat, spitalet.

Z. M. Çakaj: Po, qartë e kam parë draftin, i keni dhënë dhe përkufizimet asetëve publike. Kam dhe një pyetje tjetër, në këndvështrimin tuaj sepse unë nuk e gjej të pasqyruar në draft, procesin e standardizimit dhe të strukturimit, të normimit të veprimtarive të ndaluara, si për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë, ashtu dhe për zgjedhjet e përgjithshme vendore. Në gjykimin dhe vlerësimin e administratës dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, siç është në cilësinë e propozuesit. Këto ndalime dhe kufizime vlejné vetëm për zgjedhjet parlamentare, të paktën ndalimi i akteve, i miratimit të akteve juridike apo edhe për zgjedhjet e përgjithshme vendore? Kemi pasur një problematikë përpara zgjedhjeve të vitit 2023, kur ne, të paktën unë dhe kolegja Vukaj e vlerësojmë se përbën veprimtari të ndaluar, si rritja e pagave, ashtu edhe rritja e pensioneve përpara një periudhe katër muaj përpara zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Ndërkohë, nuk e di se çfarë mendimi ndajnë kolegët e tjerë, por të paktën Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndante mendimin që nuk përbën veprimtari të ndaluar për zgjedhjet e përgjithshme vendore. Nuk e gjej të pasqyruar në draftin e propozuar këtë qasje, mund të kem një përgjigje?

Znj. P. Doçaj: Po, duke qenë se ne i kemi qëndruar strikt nenit 91, në këtë rast, pika 4, aty ku thuhet: “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re, pas zgjedhjeve ndalohen propozimi, miratimi dhe nxjerrja e akteve”, duke qenë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

se në këtë pikë të Kodit, kemi termin ekzakt, “formimin e qeverisë së re”, i kemi qëndruar strikt kësaj dhe këtë kemi pasqyruar në akt.

Z. M. Çakaj: Qartë, qasja juaj është për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.

Znj. P. Doçaj: Për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare sepse do të duhej ndoshta në propozimet e radhës për ndryshimin e Kodit të qartësohet, të paktë kjo pikë.

Z. M. Çakaj: Qartë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Unë do të shtroj pyetjet e mia, po në vazhden e pyetjeve që ngriti kolegu sepse ka interes. Kolegu ngriti pyetjen që çfarë ju nxiti ju, domethënë cilat ishin rastet më së shumti, që përbënë shqetësim në këto katër vite të ushtrimit dhe të zbatimit të vendimit nr. 9, të cilat ju grishën që ju të merrnit një kohë të gjatë për të draftuar propozimin e sotshëm, pra Komisionerit. Pra kush janë ato raste që përbëjnë vërtet fenomen, ku me të vërtetë shihet që institucionet s’e kanë kuptuar, institucionet e kuptojnë por duan ta shkelin, institucionet e kuptojnë por nga KQZ-ja është e pamundur për t’u zbatuar për arsye të ndryshme. Pra, cilat janë ato raste? Së dyti ku konsiston dallimi midis zgjedhjeve 2021, 2023 apo zgjedhje të tjera të pjeshme pra dhe shkeljeve të kryera në ato zgjedhje dhe shkeljeve të kryera me çeljen e siparit të këtyre zgjedhjeve parlamentare? Pra çfarë ju ka bërë përshtypje deri tani nga denoncimet, nga ajo që shikoni në media, në raport me aplikimin e këtij vendimi dhe zbatimin e këtij vendimi, i cili na shkon përshtat ne si KQZ që ta marrim

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

në konsideratë ose ju e keni marrë ndoshta në konsideratë me rastin e propozimeve tuaja? Do vazhdoj dhe me pyetje të tjera.

Znj. P. Doçaj: Mendoj se një pjesë të përgjigjes e ezaurova. Pra në rastin konkret...

Znj. H. Vukaj: Nuk e gjeta në fakt.

Znj. P. Doçaj: Dakord. Raste konkrete nëse ju doni, ne mund edhe të nxjerrim të gjithë problematikat, se i kemi të evidentuara, unë nuk i kam për momentin, megjithatë në interpretim të të gjithë vendimit nr. 9, ashtu sikundër edhe jo vetëm në këtë tryezë po dhe më gjerë është...

Znj. H. Vukaj: Pra, ju zonja Doçaj në momentin kur jeni ulur dhe keni draftuar apo keni punuar në grup, a është punë e Komisionerit individuale, këtë nuk e di. Ku jeni qasur, te cilat problematika? Ku është thembra e Akilit sot? Çfarë bëjnë sot institucionet në indiferentizëm të këtij vendimi? Kjo është më e thjeshta se ne e shohim ditën për diell se çfarë bëjnë por institucionalisht, çfarë na vret ne si KQZ sot? Pse jemi ulur në këtë tryezë, të shqyrtojmë propozimin tuaj dhe në të njëjtën kohë të vlerësojmë gjithë rrethanat, me të cilat përballemi sot si natyrë vështirësie më tepër?

Znj. P. Doçaj: Të gjitha institucionet ose të paktën ato problematikat e hasura, të paktën prej meje, nuk janë të qartë në lidhje me aplikimin e këtij vendimi. Duke qenë se konfondohen, pra duke qenë se është i ndarë në dy pjesë, ajo e veprimtarive, e deklarimit të veprimtarive, raportimit të veprimtarive dhe pjesa e veprimtarive të ndaluara, ka konfuzion në aplikim të këtij vendimi. Çfarë duhet të bëjnë katër muaj

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 5.02.2025*

para zgjedhjeve, në afatin, kush është periudha zgjedhore? Pra a duhet katër muaj para të mos nxjerrin akte apo duhet vetëm në periudhë zgjedhore të mos nxjerrin akte apo të përdorin këto asete.

Znj. H. Vukaj: Kur presin shirita për shembull inagurimi apo ndajnë certifikata pasurish të paluajtshme apo certifikata të pronave që legalizohen? Kjo për shembull nuk ka përbërë fenomen për ju për ta inkorporuar apo integruar si risi, ndryshim?

Znj. P. Doçaj: Ne këtë propozim kemi në fakt dhe e kemi parë, e qasim në këtë formë, patjetër që nëse ju e çmoni ne do të pasqyrojmë në këtë akt çdo ndryshim apo çdo sugjerim tuajin, patjetër që do të jetë shumë i vlefshëm dhe për shkak të eksperiencës të proceseve zgjedhore që janë zhvilluar deri tani.

Znj. H. Vukaj: Ndaj unë shtrova pyetjet, me qëllim që në kuadër të fenomenit, vështirësive tuaja ne t'i merrnim në konsideratë gjatë shqyrtimit, por unë nuk mora përgjigje, thjesht ishte një përgjigje e cila justifikon deri diku këtë përmbajtjen narrative, por jo thelbësore sepse sot më e rëndësishme se kurrë është që t'i japim impulsin e duhur ushtrimit të këtij vendimi, pra zbatimit siç duhet të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



Znj. H. Vukaj: Ndaj unë shtrova pyetjet më qëllim që në kuadër të fenomenit, të vështirësive tuaja, ne ti merrnim në konsideratë gjatë shqyrtimit. Por unë nuk mora përgjigje ishte një përgjigje e cila justifikon deri diku këtë përmbatjen narrative por jo thelbësore sepse sot më e rëndësishme se kurrë është që ti japim impulsin e duhur ushtrimit të këtij vendimi. Pra, zbatimin siç duhet të këtij vendimi, i cili në fakt për hirë të së vërtetës ka qenë i mirë deri diku, po pavarësisht se sa vullnet ka pasur për ta zbatuar atë apo për ta aplikuar atë siç duhet. Së dyti për procedurë kam dy pyetje. Po i kthehem në retrospektivë mbledhjes së kaluar ku ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator ne ekzigjencën dhe emergjencën për ta bërë sa më të efektshëm dhe efektiv këtë vendim propozuam ndryshime që absolutisht i konsiderojmë thelbësore për mbarëvatjen dhe impaktimin e kësaj gare që duhet të jetë e barabartë. Pra, mos t'i lihen privilegjet njërës palë e cila ka pushtetin por zotëron edhe institucionet publike, në këtë kuadër ne sollëm propozimet tona të cilat kolegët tanë me vullnetin e tyre, sollën si justifikim edhe qasje rrëzohen direkt që në parim për hirë të unitetit dhe integritetit që duhet të plotësonte si akt. Këtë qasje e kishin edhe organizatat jo qeveristare të cilat na ndjekin, ndjekin e dhe këtë proces të cilat dhe kontribuojnë në këtë proces. Sigurisht me vullnetin e tyre të lirë dhe pa imponim, kishin qasjen që të dy draftet të bashkëlidhen, të integrohen, të inkorporohen , në këtë kuadër unë po bëj një pyetje për transparencë të atyre që na ndjekin këtu edhe përtej kësaj salle. Ky akt a është një akt i unifikuar dhe a ka shqyrtuar ky akt dhe a ka marrë në konsideratë edhe propozimet tona, timin personal dhe të kolegut Çakaj?

Znj. P. Doçaj: Jo, nuk është një akt i integruar me propozimet tuaja. Patjetër që...

Znj. H. Vukaj: Pra, përgjigjen e morëm, ky nuk është një akt i integruar, pra kolegët sot kanë sërish argumentin që propozimet e dy kolegëve të tjerë nuk janë marrë në konsideratë edhe pse janë utilitare, edhe pse janë të bëra nga dy juristë me shumë përvojë, edhe pse janë një përmbatje shumë e mirë në dijeninë tonë edhe pse do ti shërbejnë jashtëzakonisht procesit nuk qenkërkan marrë në konsideratë. Së dyti, doja të dija ky është një akt i ri, apo ndryshim në aktin ekzistues?

Znj.P.Doçaj: Atëherë, po të shikojmë dispozitat e fundit të projektvendimit ne kërkojmë që vendimi nr.9 i datës 24.12.2020 me përjashtim të neneve 1.1, 4, 5 dhe 9 të shfuqëzohet duke e bërë këtë një akt të ri. Në lidhje më mënyrën se si do të jetë mbarëvatja apo vendimmarrja juaj ne mendojmë që duhet të ketë dy akte të mëvetme. Pra, veprimtaritë e ndaluara dhe sjellja e institucioneve dhe raportimi i veprimtarive të jenë dy akte të mëvetme. Në rast se ju do të miratoni këto ndryshime në këtë vendim patjetër që nga ana jonë do të propozohet një akt i ri i lidhur me veprimtaritë. Duke përmbajtur gjithmonë atë përmbatjen e propozuar më parë , atë të miratuar por ideja është që duhet të jenë dy akte të mëvetme për të pasur më qartësi në aplikimin e tyre.

Znj. H. Vukaj: Në kujtesën tonë dhe në kujtesën tuaj besoj është e freskët sepse është Dhjetori 2024, ne në momentin e kushtëzimit që ky proces do të duhej të ndryshonte si pjesën e raportimit ashtu edhe atë të veprimtarive të ndaluara sollëm edhe propozimin në diskutim që të kishte edhe dy akte të veçuara dhe kjo nuk u mirëprit dhe tani gjendemi përballë faktit që duhet patjetër të kemi dy akte të veçuara. Ndërkohë që kjo duhet të na ishte bërë me dije më përpara, megjithatë kjo nuk është bërë më dije më përpara dhe situata duket në kushte përmbajtësore, formale dhe proceduriale secila është dhe nga ana tjetër personalisht kam, nuk po them vëretje, në kuadër të teknikës legjislative atë

mungesën e qasjes me mënyrën se si e keni sjellë këtë akt. Megjithatë mbetet në vlerësimin e kësaj tryeze që ta shqyrtojë më tutje se si do vijoj ky akt.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Edhe unë kam një pyetje drejtuar administratës në vijim të shqetsësimit të ngritur nga kolegja Vukaj, dhe në vijim të diskutimit të mbledhjes së kaluar, kur thamë që kemi edhe mendime të organizatave të shoqërisë civile kur përmenda organizatën KRIIK dhe Komitetin Shqiptarë të Helsinkit që kishin sjellë posaçërisht për mbledhjen e kaluar mendime. Një prej tyre ishte lidhur me projektvendimin e propozuar nga kolegët dhe një prej tyre me vendimin e propozuar nga Komisioneri, mesa shoh nuk është reflektuar asgjë prej tyre. Pra, çfarë vlerësimi keni pasur që nuk keni reflektuar në projektakt ndonjë prej rekomandimeve apo propozimeve konkrete?

Znj. P. Doçaj: Nga ana e organizatës në fakt është sjellë pak me vonesë si akt, megjithatë duke qenë se janë rekomandime të ndara në lidhje me projektvendimin e propozuar nga dy anëtarët dhe në lidhje me propozimin e këtij projektvendimi të propozuar nga Komisioneri. Ato rekomandimet për Komisionerin kishin të bënin vetëm me terminologjinë që ka të bëjë me veprimtaritë publike me karakter politik, pra unifikohen termat apo veprimtaria ndjek qëllime elektorale, ishin dy propozime që kanë të bëjnë me terminologjinë të cilat bëjnë sens dhe mund të reflektohen në zbardhjen e projektvendimit. Ndërsa për pjesën tjetër kanë të bëjnë me rekomandime të cilat i përkasin aktit të propozuar nga anëtarët.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Mesa shoh përfaqësuesja e KRIIK do të saktësoj.

Znj. I. Nano: Po mundesh!

Përfaqësuese e KRIIK: Atëherë, një saktësim kërkesa e parë që ka ardhur ka qenë referuar të projekt propozimeve që të dyja kishin me qëllim për synim të njëjtin vendim. Kërkesa e parë ka qenë unifikimi i akteve, mbledhja e tyre dhe më së shumti pjesa e konsultimit të gjërë të këtij akti, për shkak të rëndësisë që ai përmban. Rekomandimi i dytë, ka ardhur referuar faktit që mbledhja u njoftua dhe nuk kishte më asnjë informacion nëse do ishte edhe akti i dytë i përfshirë tek propozimet e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator. Përsa i përket përmbatjes së rekomandimeve në dokumentin e dytë. Vërtet janë dy ndarje në fund teknike lidhur me propozimet e anëtarëve të Komisionit Rregullator edhe lidhur me atë të Komisionerit por i gjithë rekomandimi paraprihet nga nevojat që mbart vendimi nr.9 që kanë të bëjnë me unifikimin e periudhës zgjedhore, për këtë bëhet fjalë në terminologji, është parë shpesh që periudha zgjedhore herë i referohemi fushatës 30 ditë, herë i referohemi 4 muaj përpara ditës së zgjedhjeve. Ky akt do të duhet ta unifikojë kush është periudha zgjedhore, në përmbatje të të gjithë aktiviteteve të lejuara apo të ndaluara në të. Pjesa e publikimit paraprakë të të gjithë aktivitetit financiar të institucioneve shtetëore. Është e pa mundur sot të kuptosh nëse një akt i propozuar dhe i miratuar nga parlamenti apo këshillat bashkiak është një akt i cili ka qenë në planin buxhetor apo një akt që është futur rishtazi, çka e dyta është e ndaluar në fakt sipas ligjit. Gjithashtu ka propozime lidhur me një përkufizim më të qartë të autoritetit shtetëror çfarë jo vetëm të aseteve shtetërore sikurse ligji i përmban po të asaj që është “ofiqi publik” terminologjia që kemi përdor dhe më tej ndoshta kjo është fraza që kemi gjetur më të përshtatshme që ka të bëjë me autoritetin shtetëror. Ka edhe disa rekomandime të tjera që pasojnë që është leje për anëtarët e KZAZ-ve për aq sa kujtoj se nuk e kam përpara tani dokumentin. Kështu që propozimet që janë...

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



Znj. I. Nano: Është miratuar në një projekt vendim tjetër ai rekomandim për lejen...

Përfaqësuese e KRIIK: Po por duke qenë që ka të bëjë me angazhimin e administratës në aktivitet që ka të bëjë me administrimin e zgjedhjeve ne e pamë të arsyeshme që duhet të jetë edhe këtu. Jemi në dijeni që është përfshirë tani më edhe tek dokumenti për KZAZ-të sepse ka qenë një propozim i hershëm i joni. Vetëm për të saktësuar edhe njëherë, pjesa e parë e dokumentit ka të bëjë me të gjitha rekomandimet tona për nevojën për përmirësim në vendimin nr. 9 por janë rekomandime në nivle të përgjithshëm po me gjithë respektin dhe dakordësinë e të dyja akteve të paraqitura, ne vazhdojmë të gjykojmë që ato do të duhet të integrohen në një të vetëm dhe të konsultohen më tej për të pasur një rezultat që është realisht efektiv. E kuptoj që koha nuk premtion por duke qenë se tashmë jemi përballë faktit që tashmë periudha 4 mujore ka filluar ai afati i datës 11 Janar ka kaluar, ndoshta është më mirë që të merren edhe pak më shumë ditë dhe të arrihet në një akt të konsoliduar mirë se sa të nxitojmë për efekt të kohës po pastaj të na duhet përsëri që ti rikthem i këtij akti.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Kisha edhe diçka në lidhje me konstatimin që bëri përfaqësuesja e organizatës KRIIK në parim jam dakord për unifikimin e periudhës por duhet të marrim në konsideratë edhe parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor pika 2 dhe pika 3 ku bëhet fjalë posaçërisht ku pika 2, pika 3 dhe pika 4 ku bëhet fjalë posaçërisht për disa veprimtari të ndaluara ndalimi për tu zhvilluar është posaçërisht është evidentuar termi fushatë zgjedhore , “ pra gjatë fushatës zgjedhore” si në pikën 2 dhe në pikën 3 ndërkohë për disa veprimtari të tjera,

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.05.02.2025*

miratimi i akteve juridike është evidentuar periudha 4 muaj në këto kushte qoftë në vendimin numër 9 , vitit 2020, qoftë në propozimin që bëmë ne por mesa duket edhe në propozimin që ka bërë Komisioneri janë evidentuar qartë këto dy periudha. Pra, qartazi ndodhemi përballë faktit që kemi dy periudha periudhën 4 muaj dhe periudhën 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve sepse na kushtëzon Kodi Zgjedhor kështu që do të duhet që nenet autorizuese, normat autorizuese në kod ti materializojmë në propozimet tona. Së dyti, unë e vlerësoj maksimalisht rithirrjen tuaj për integrimin e këtij projekt akti në një të vetëm si propozimet që unë dhe kolegja Vukaj ashtu në propozimin e sjellë nga Komisioneri dhe pavarësisht se ka filluar periudha 4 mujore. Unë në rastin konkret gjej mundësinë ti rikërkoj edhe njëherë administratës nëse ka vullnet dhe nëse e sheh të arsyeshme të marri kohën të konsultohet me Komisionerin dhe të rishoh mundësinë e integritit edhe të draftit tonë të pikave që e që ata e gjykojnë të arsyeshme me qëllim paraqitjen e një drafti të unifikuar të opranuar nga të gjitha palët i cili adreson shqetësimet e ndodhura e vëzhguara, e konstatuara e gjithë periudhës katër vjeçare e gjithë proceve zgjedhore që ne kemi ezauruar. Kështu që e ftojë administratës që të vlerësojë edhe njëherë me kërkesë drejtuar kolegëve mund ta ndërpresim mbledhjen marrim një 5 -10 minuta pushim marrim një përgjigje shteruese nga Komisioneri nëse e sheh mundësinë që ta rishoh aktin dhe të bëjë një draftë të unifikuar me propozimet e tij, me propozimet tona dhe sigurisht me sugjerimet, vëretjet, shtesat e KRIIK apo e organizatave të tjera, të cilat kanë propozuar. Kështu që siç e shikoni të arsyeshme mund të marrim një 5-10 minuta pushim vlerësojeni dhe të marrim një përgjigje përfundimtare.

Z. I. Nano: Një diskutim të vogël edhe unë meqë jemi tek periudha zgjedhore dhe pastaj mund ta ndërpresim 10 minuta mbledhjen. Në fakt ajo që kolegu Çakaj tha është shumë e drejtë në nenin 91 kemi dy periudha të ndryshme në të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



cilat aplikohen ndalime të ndryshme. Njëra është periudha e fushatës zgjedhore që është 30 ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve, tjetra është në mënyrë eksplicite 4 muaj para zhvillimit të zgjedhjeve, kemi disa ndalime deri ditën e zgjedhjeve për të mos thënë që disa ndalime të tjera i kemi 4 muaj deri në formimin e qeverisë së re. Ndërkohë në kuptim të përkufizimeve të Kodit Zgjedhor për atë se çfarë quhet periudhë zgjedhore në nenin e përkufizimeve në nenin 2 periudhë zgjedhore është periudha e vitit e përcaktuar në këtë kod gjatë të cilës zhvillohen zgjedhjet periodike të rradhës për Kuvendin dhe Organet e Qeverisjes Vendore. Në nenin nr.9 ku flitet për caktimin e datës së zgjedhjeve ku thuhet se zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen në një ditë të Diel brenda periudhës zgjedhore të caktuar në nenin nr.8 dhe neni 8 me periudhë zgjedhore përcakton dy të tilla gjatë vitit, 15 Prill – 15 Maj ose 15 Tetor -15 Nëntor. Pra, më shkoqur se kaq Kodi Zgjedhor nuk ka çtë thotë, ti ka thënë cilat janë periudhat zgjedhore. Pra, periudhat zgjedhore përtej këtyre ne nuk mund të caktojmë. Periudha ku ka ndalime është tjetër gjë, po periudhë zgjedhore nuk mund të unifikojmë më, është e mirëpëcaktuar në Kodin Zgjedhor kush janë periudhat.

Përfaqësuese e KRIIK: Nëse mundem, nuk është kërkuar përcaktimi i termit periudhë zgjedhore. Unifikimi, sepse në disa shqyrtime të bëra në KAS lidhur me denoncime të ndryshme ka qenë diskutim dhe ka qenë edhe arsye për votim në disa raste. Unë gjykoj që periudhë zgjedhore në këtë rast është fushata. Unë gjykoj që... gjithësecili patjetër është në të drejtën e vet, për të pasur gjykimin e vet juridik, që periudha zgjedhore është 4 muaj. Unë gjykoj që është që nga dekretimi.gjykoj që mund të jetë 6 muaj përpara ditës së zgjedhjeve këto janë të gjitha...

Znj. I. Nano: Unë po lexoj nuk po mendoj... Unë po lexoj Kodin Zgjedhor,

Përfaqësuese e KRIIK: Ajo që është kërkuar është unifikimi në këtë akt i asaj se çka përbën periudhë zgjedhore.

Znj. I. Nano: Ajo i bie që të ndryshojmë Kodin Zgjedhor me akt normative, pra, kur të thotë qartë kush është periudhë zgjedhore dy janë të tilla gjatë vitit. Në këtë kuptim 15 Prill-15 Maj, 15 Tetor -15 Nëntor këto janë dy periudhat zgjedhore. Dhe periudha zgjedhore është periudha kur zhvillohen zgjedhjet të rradhës për Kuvendin apo për Organet e Qeverisjes Vendore. Megjithatë me propozimin e kolegut Çakaj e vlerësoni të bëjmë një ndërprerje të shkurtër të mbledhjes dhe e fillojmë për 10 minuta-15 minuta.

Rifillon mbledhja

ora 13 04

Znj. I. Nano: Rifillon mbledhja bëmë një pushim të shkurtër për të bërë një konsultim me propozuesin e aktit Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Zonja Doçaj ju lutem!

Znj. P. Doçaj: Po! Faleminderit, në lidhje me propozimet e bëra nga ana juaj por edhe me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ne mendojmë që do të duhet ta shtyjmë këtë seancë. Për të vlerësuar nëse të dyja aktet do të integrohen për të sjellë një akt i cili të ezaurojë të gjitha problematikat e vendimit nr.9 dhe të merren dhe në shqyrtim edhe propozimet e organizatës KRIIK dhe propozimet e organizatave të tjera. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Atëherë, kolegë unë propozoj që mbledhjen ta shtymë pra, të pezullohet shqyrtimi i këtij projektakti deri në momentin që nga ana e Komisionerit të na vijë një propozim i ri. Nuk e di nëse jeni dakord? Dakord, atëherë për sot e mbyllim, faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**

